



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor

Nr : 04-353/01-70072

Data: 13.03.2024

Prizren

**DREJTORIA PËR URBANIZËM DHE PLANIFIKIM HAPËSIROR KK – PRIZREN,** me kërkesën nga **Teqja e Madhe e Tarikatit Saadi** me seli në rrugën „Vatrat Shqiptare”, nr. -/- – Prizren, me të cilën kanë kërkuar leje për kyçjen në rrjetin e ujësjellësit në rrugën “Vatrat Shqiptare”nr., në bazë të nenit 3 paragrafi 1 pika 1.1, 1.4, 1.24, si dhe nenit 5, paragrafit 1.1 e lidhur me nenin 14 paragrafi 1 pika 1.1 nenit 15 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit për Ndërtim numër 04/L-110, dhe sipas Vendimit për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Prizrenit (HZK) për periudhën 2022 – 2030 – Numër 001-011-48192 të datës 31. 03. 2022 si dhe konform nenit 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 44, 46, 47, 48 dhe nenit 125 të L.P.P.A numër 05/031 të datës 25. 05. 2016 si dhe neni 142 paragrafi 3 vendimit numër 01/011-2 data 18. 11. 2002 merr këtë:

## AKTVENDIM

**I LEJOHET: Teqja e Madhe e Tarikatit Saadi nga Prizreni** me të cilën ka kërkuar leje për për kyçjen në rrjetin e ujësjellësit e cila ndodhet në rrugën “Vatrat Shqiptare”nr., per objektin qe eshte ne ng.kadast.P-71813068-01882-0 ZK.Prizren , kurse kyçja për në rrjetin e ujësjellësit do te behet ne ng.kadast. P-71813068-01883-0;01887-0;01884-0; Z.K.Prizren

- I. Datën e fillimit të punimeve investitori është i obliguar që të lajmërojë inspektionin komunal në afat prej 8 ditësh.
- II. Vendosija e rrjetit të bëhet sipas dokumentacioni teknik..

- Investitori është i obliguar që punimet të kryen në bazë të dokumentacioni teknik-projektit e në pajtim me normat ndërtimore dhe rregullave teknike për kësi llojë punime.

Kjo Leje bazohet në shqyrtimin e provave:

- Pëlqim nga Hidroregjioni Jugor nr.266 të dt. 30.11.2022
- Sipas pëlqimit të KEDS-it.nr.134 dt.25.01.2024
- Sipas pëlqimit të Drejtorisë Shërbimeve Publike Nr. 06/2024 dt.06.03.2024.
- Sipas pëlqimit Telekomit i Kosovës – Departamenti Teknik nr. 171/2023 të datës 05.07.2023.
- Vendimit nga QRTK-ja me nr.178/3 dt.12.07.2023

III. Investitori është i obliguar që punimet rreth infrastruktures termike të kryen sipas Aktvendimit të dhëna, kurse vend punimi natën të ndriqohet me dritë ashtu që të mundësohet qarkullimi i lirë i automjeteve dhe të këmbësorëve, kurse materialet të tjera duhet të menjanohen nga rruget ku janë kryer punimet.

IV. Ky aktvendim pushon të vlejë në rastë se me punë nuk fillohet mbrenda afatit prej 12(dymbdhjetë) muajsh,duke llogaritur nga dita e marjes së të njëjtës

V. Pas kryerjes së punimeve Investitori është i obliguar që vendin menjëherë të bjerë në gjendje të mëparshme dhe cdo demtim obligimi mbetet investitorrit.

VI. Në qoftëse punimet në infrastrukture nuk mund të kryen në afatin e lejuar, Investitori është i obliguar që të kërkoj nga ky organ leje për vazhdimin e afatit të punimeve.

VII. Ky aktvendim pushon të vlejë në rastë se me punë nuk fillohet mbrenda afatit prej 12(dymbdhjetë) muajsh, duke llogaritur nga dita e marjes së të njëjtës

## A r s y e t i m

**Teqja e Madhe e Tarikatit Saadi nga Prizreni**, është drejtuar këtij organi për marrjen e lejes për : **kycjen në rrjetin e ujësjellësit** e cila ndodhet në rrugën “Vatrat Shqiptare”nr. ,per objektin qe eshte ne ng.kadast.P-71813068-01882-0 ZK.Prizren , **kurse kycja për në rrjetin e ujësjellësit** do te behet ne ng.kadast. P-71813068-01883-0;01887-0;01884-0; Z.K.Prizren

Duke shqyrtuar kërkesën e Investitorit si dhe dokumentacionit teknik dhe të shtojcave tjera të prezentuara s’bashku me kërkesë vërtetohet se:

Në procedurën paraprake është kontrolluar dokumentacioni teknik nga ana e bashkëpunorit profesional.

Në kuptim të dispozitave të lartë theksuara është konstatuar se janë plotësuar kushtet për dhënien e lejes për: **kurse kycja për në rrjetin e ujësjellësit** rrugën “Vatrat Shqiptare”, nr. KK Prizren.

Nga se u tha më lartë uvendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e marjes së të njëjtës Ministrisë së Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor-Prishtinë.

Ankesa taksohet me 0,50 Euro taksa administrative.

**Bashkëpunëtore profesionale:**

Egzona Morina-Thaq, ark.dipl.

**DREJTORI:**

  
Pranverim Berisha, jur. dip.